



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT  
MINISTRIA E MJEDISIT JETËSOR DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

**Propozim-ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ujërat (\*)**

Shkup, shkurt 2022

---



## **HYRJE**

### **I. VLERËSIM I GJENDJEVE NË FUSHËN QË DUHET TË RREGULLOHET ME LIGJIN DHE SHKAQET PËR MIRATIMIN E LIGJIT**

Bazuar në zbatimin aktual të Ligjit për ujërat, inspektimet mbikëqyrëse aktuale në fushën e ujërave, raportet e revizionit të kryera në të cilat janë identifikuar mangësi të caktuara dhe janë dhënë rekomandime për tejkalimin e tyre, janë bërë ndryshime në Ligjin për ujëra.

Arsyet kryesore për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit rrjedhin nga:

1. Nevoja për saktësimin dhe sqarimin të përkufizimeve të caktuara në ligj, si dhe shtimin e përkufizimeve të reja që do të mundësojnë zbatimin më të lehtë dhe më efikas të dispozitave në ligj;
2. Nevoja për plotësimin dhe saktësimin e procedurave për dhënien e lejeve për shfrytëzimin e të drejtës së ujit për zbatim më efikas;
3. Ndryshimi i procedurës për mbrojtjen dhe përmirësimin e regjimit ujqor me heqjen e rërës, zhavorrit dhe gurëve nga shtretërit e lumenjve dhe brigjet e trupave ujqorë sipërfaqësorë me përcaktimin e lejes për rregullimin e shtretërve të lumenjve dhe brigjeve të trupave ujqorë sipërfaqësorë në përputhje me rekomandimet dhe konkluzionet e dhëna në raportin e revizionit të suksesit me temë “Efektin e politikave, masave dhe aktiviteteve në shfrytëzimin e zhavorrit dhe rërës nga pellgu i lumit Vardar”.
4. Sigurimit të transparencës më të madhe të procedurës për dhënien e koncesioneve edhe për përdorimin e ujit.

### **II QËLLIME, PARIME DHE ZGJIDHJE THEMELORE**

Qëllimi kryesor i propozim-ligjit është që të specifikojë dhe sqarojë më tej disa dispozita të Ligjit të cilat do të mundësojnë zbatimin më të lehtë dhe më efikas.

Disa nga zgjidhjet në ligj do të mundësojnë përkufizimin dhe përcaktimin e aktiviteteve specifike të organeve dhe institucioneve përgjegjëse në zbatimin e ligjit për ujërat. Rregullimi shtesë i dispozitave të mbikëqyrjes inspektuese duhet të rezultojnë me mbikëqyrje më efikase në fushën e ujërave.

Mundësia e përfshirjes së publikut në procedurën për dhënien e koncesionit për shfrytëzimin e ujit do të mundësojë transparencë më të madhe të gjithë procesit të dhënies së koncesioneve.

### **III. VLERËSIMI I PASOJEVE FINANCIARE NGA PROPOZIM - LIGJI MBI BUXHETIN DHE MJETET E TJERA FINANCIARE PUBLIKE**

Miratimi i propozim-ligjit do të shkaktojë implikime financiare pozitive për shkak të ndryshimit të arkëtimit të një pjese të kompensimeve dhe forcimit të mënyrës së monitorimit të mbledhjes së tyre, gjë që do të ndikojë në rritjen e arkëtimit të tyre.

### **IV. VLERËSIMI I MJETEVE FINANCIARE TË NEVOJSHME PËR ZBATIMIN E LIGJIT, MËNYRËN E SIGURIMIT TË MJETEVE, TË DHËNA NËSE ZBATIMI I LIGJIT TËRHEQ OBLIGIME MATERIALE PËR SUBJEKTE TË VEÇANTA**

Ligji vendos detyrime të reja në lidhje me dhënien e lejeve për të drejtën ujore si dhe dhënien e koncesionit për përdorimin e të drejtës së ujit në lidhje me nevojën për paraqitjen e dokumentacionit shtesë, përgatitja e të cilit do të shkaktojë mjete financiare materiale për subjekte të caktuara.

## **V. HARMONIZIMI I PROPOZIM-LIGJIT ME TË DREJTËN E BASHKIMIT EVROPIAN**

Propozim - ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ujërat harmonizohet me:

- Direktivën Kornizë për Ujërat 2000/60 / EC (CELEX 32000L0060) dhe
- Direktivën 2006/118 / KE për mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotja dhe përkeqësimi i gjendjes së tyre (CELEX 32006L0118).

## **VI. PASQYRË E DISPOZITAVE QË DUHET TË MIRATOHEN PËR ZBATIMIN E LIGJIT**

- Urdhëresë për rastet, si dhe kushtet dhe procedurën e shmangies nga objektivat për mjedis jetësor (neni 95);
- Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e regjistrit e përcakton ministri që udhëheq organin e administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e punëve nga fusha e mjedisit jetësor (neni 96);
- Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës dhe të lejes (neni 142 - a);
- Rregullore për formën dhe përmbajtjen e formularit dhe mënyrën e mbajtjes së ditarit (neni 142-c);
- Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e faturave, formën dhe përmbajtjen e regjistrit të faturave të lëshuara dhe të certifikuara e përcakton ministri që drejton organin e administratës shtetërore përgjegjës për punët në fushën e ekonomizimit me ujërat (neni 142-g);
- Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e elaboratit nga paragrafi (2) i këtij neni, e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor (neni 198).

## PROPOZIM-LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR UJËRAT ( \*)

### Neni 1

Në Ligjin për ujërat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 87/2008, 6/09, 161/09, 83/10, 51/11, 44/12, 23/13, 163/13, 180/14, 146/15, 52/16 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës të Maqedonisë së Veriut" nr. 151/21) në nenin 4 në paragrafin (1) pika 33 ndryshohet si vijon:

"Shërbimet e ekonomizimit me ujërat, me të cilat sigurohet përfshirja, pompimi, akumulimi, kullimi, trajtimi dhe shpërndarja e ujërave sipërfaqësore ose nëntokësore, ose grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura që derdhen në ujërat sipërfaqësore, si dhe shërbimet që ofrojnë përmirësimin e regjimit të ujërave dhe mbrojtje nga efektet e dëmshme të ujërave."

Pas pikës 41 shtohet pika 41-a, si më poshtë:

"41-a. Aglomerimi është zona në të cilën popullsia dhe/ose aktivitetet ekonomike janë të përqendruara në masë të mjaftueshme që ujërat e zeza komunale të grumbullohen dhe të kanalizohen në impiantin e trajtimit të ujërave të zeza komunale ose deri në pikën përfundimtare të shkarkimit;"

Në pikën 44. fjala "ndërkombëtare" zëvendësohet me fjalën "ndërkufitare".

Në pikën 66 fjalët "shkarkim dhe" zëvendësohen me fjalët "shkarkim dhe/ose".

Pas pikës 66 shtohen pika të reja 67 dhe 68 si më poshtë:

„67. Vërshim është mbulesë e përkohshme e tokës me ujë që normalisht nuk është nën ujë dhe përfshin përmytjet nga lumenjtë, përrenjtë dhe liqenet.

68. Rrjedha ekologjike është rrjedha që siguron cilësinë, sasinë dhe shpërndarjen kohore të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore të nevojshme për të ruajtur funksionet dhe proceset e ekosistemeve të varura, nga të cilat varen edhe njerëzit;"

### Neni 2

Në nenin 6 në paragrafin (3) pas fjalës "shkarkimi" shtohen fjalët "ndërtimi i objekteve dhe vendosja e instalimeve në ujëra".

### Neni 3

---

( \*) Ky Ligj është i harmonizuar me Direktivën kornizë për ujëra 2000/60 / EC (CELEX 32000L0060) dhe Direktivën 2006/118 / EC për mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotja dhe ruajtjen e gjendjes së tyre (CELEX 32006L0118).

Titulli i nenit 9 ndryshon, si vijon:

“Menaxhimi i ujërave të pellgjeve lumore ndërkufitare”.

Në nenin 9, fjala "ndërkombëtare" zëvendësohet me fjalën "ndërkufitare", fjala "ndërkombëtares" zëvendësohet me fjalën "ndërkufitaires", ndërsa fjala "ndërkombëtares" zëvendësohet me fjalën "ndërkufitare".

#### **Neni 4**

Në titullin e nenit 10, fjala "Ndërkombëtare" zëvendësohet me fjalën "Ndërkufitare“.

Në paragrafin (1) fjala “ndërkombëtare” zëvendësohet me fjalën “ndërkufitare”.

Në paragrafin (2) fjala "ndërkombëtare" zëvendësohet me fjalën "ndërkufitare" dhe fjala "ndërkombëtar" zëvendësohet me fjalën "ndërkufitar".

#### **Neni 5**

Në nenin 17 në paragrafin (2) pas fjalës "ekonomi familjare" shtohen fjalët ".pas njoftimi paraprak të organit të administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e punëve profesionale nga fusha e menaxhimit të ujërave në pajtim me nenin 201 paragrafi (1) të këtij ligji”.

Pas paragrafit (3) shtohet paragrafi i ri (4) si vijon:

(4) Mendimin nga paragrafi (3) alineja 3 e këtij neni, organi i administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e punëve profesionale nga fusha e menaxhimit me ujërat e nxjerr në bazë të:

- fletë pronësisë dhe kopje të planit kadastral të parcelave në vendin ku do të përfshihet, gjegjësisht nxirret ujë ose dokument që vërteton se kërkuesi është bartës i një të drejte tjetër reale mbi parcelën;
- hartë topografike me përmasa 1: 25.000, me pozicionim të koordinuar në vendin e angazhimit përkatësisht pompimit të ujit; dhe
- llogaritja e sasive të nevojshme të ujit për ujitje sipas sipërfaqes së ujitur dhe kulturës."

#### **Neni 6**

Në nenin 21 pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3) si vijon:

“(3) Ujërat nëntokësore që në bazë të lejes së përdorimit të ujit përdoren për ngrohje përmes thithjes së energjisë termike, duhet të kthehen në të njëjtin trup nga ku janë kapur, në mënyrën dhe kushtet e përcaktuara në leje.”

#### **Neni 7**

Në nenin 28 , paragrafi (4) ndryshon si vijon:

“Për objektet dhe instalimet për të cilat kërkohet leja nga paragrafi (1) pika 3) të këtij neni, ndërsa për të cilat me dispozitat për mjedis jetësor përcaktohet se kërkohet leje mjedisore A, përkatësisht B, leja merret nën kushtet dhe mënyrën e përcaktuar me dispozitat që rregullojnë lëshimin e lejeve të integruara mjedisore”.

Në paragrafin (5) fjalët "për instalimet në zonë të mbrojtur" shlyhen.

Paragrafët (6) dhe (7) bëhen paragrafë (5) dhe (6).

### **Neni 8**

Në nenin 29 në paragrafin (2) fjalët “objekt ndërtimor dhe parcelë ndërtimore” zëvendësohen me fjalët “parcels fqinje”.

### **Neni 9**

Në nenin 30 në paragrafin (3) alineja 3, pas fjalës “stabilimente” shtohen fjalët “që përmban veçanërisht lokacionin e objektit, nënshtresat hidrologjike, llogaritjet hidraulike dhe regjimin e përdorimit të ujërave”.

Pas paragrafit (11) shtohet paragrafi i ri (12) si vijon:

“(12) Në rast se parashtrohet kërkesa për shfrytëzimin e ujërave nëntokësore për thithjen e energjisë termike, krahas dokumenteve nga paragrafi (3) dhe paragrafi (11) i këtij neni, kërkuesi duhet të dorëzojë projektin e riinjektimit.”

Pas paragrafit (12) i cili bëhet paragrafi (13) shtohet paragrafi i ri (14) si më poshtë:

“(14) Në rastet kur kërkesa parashtrohet për shfrytëzimin e ujit për hulumtime hidrogeologjike për mbledhjen e të dhënave, krahas dokumenteve nga paragrafi (3) alinetë 1, 2, 5 dhe 6 të këtij neni, parashtruesi i kërkesës duhet të paraqesë raport për kryerjen e kërkimeve hidrogeologjike dhe hartën topografike në përmasa 1: 25 000, me pozicionim të koordinuar në terrenin e kërkimit.”

### **Neni 10**

Në nenin 33 në paragrafin (4) në pikën 1) pas fjalës "administrata" shtohen fjalët "dhe institucionet e tjera", ndërsa lidhësja "dhe" zëvendësohet me ";".

Në pikën 2) pika në fund të fjalisë zëvendësohet me ";".

Pas pikës 2) shtohen dy pika të reja 3) dhe 4) si vijon:

“3) personat juridikë përgjegjës për furnizimin me ujë për konsum nga njeriu, për rajonet për të cilat janë krijuar zona të mbrojtura në përputhje me nenin 98 të këtij ligji dhe

4) personat juridikë dhe fizikë që në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e natyrës janë përgjegjës për administrimin e zonave të mbrojtura.”

#### **Neni 11**

Në titullin e nenit 37, fjala “ndërshtetërore” zëvendësohet me fjalën “ndërkufitare”.

#### **Neni 12**

Në nenin 38 në paragrafin (4) pas numrit "1" shtohen fjalët ", 3 dhe 4".

#### **Neni 13**

Në nenin 40 pas paragrafit (1) shtohet paragrafi i ri (2) si vijon:

(2) Kundër aktvendimit me të cilin lëshohet leja nga paragrafi (1) i këtij neni mund të parashtrohet ankesë në pajtim me dispozitat për procedurë të përgjithshme administrative në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, gjegjësisht nga dita e publikimit të lejes në librin e ujërave."

Paragrafët (2) dhe (3) bëhen paragrafë (3) dhe (4).

#### **Neni 14**

Neni 41 ndryshon si vijon:

"(1) Pas dhënies së lejes nga neni 26 paragrafi (1) me qëllim të verifikimit të plotësimit të kushteve nga leja, bëhet inspektimi i objekteve dhe stabilimenteve, për të cilat lëshohet vërtetim për kryerjen e inspektimit.

(2) Për objektet dhe stabilimentet nga paragrafi (1) i këtij neni, të cilat sipas dispozitave për ndërtim bëjnë pjesë në kategorinë e parë, kontrollin e bën komisioni i formuar në pajtim me dispozitat për ndërtim.

(3) Për objektet dhe stabilimentet nga paragrafi (1) i këtij neni, të cilat në pajtim me dispozitat për ndërtim bëjnë pjesë në kategorinë e dytë, si dhe për objektet dhe instalimet për të cilat nuk është parashikuar dhënia e lejes për ndërtim, inspektimi kryhet nga Komisioni i formuar nga ministri, i cili drejton organin e administratës shtetërore përgjegjës për punët nga fusha e mjedisit jetësor, i përbërë nga pesë anëtarë, si më poshtë: një anëtar i Inspektoratit Shtetëror i Mjedisit Jetësor, dy anëtarë të organit përgjegjës për kryerjen e punëve profesionale dhe dy anëtarë të organit të administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e veprimtarive në fushën e mjedisit jetësor.

(4) Leja nga neni 26 paragrafi (1) i këtij ligji fillon të prodhojë efekt juridik pas marrjes së vërtetimit për kontrollin e kryer nga paragrafi (1) të këtij neni dhe/ose miratimit për shfrytëzimin e objekteve dhe impianteve në pajtim me Ligjin për ndërtim.



(5) Nga momenti i lëshimit të licencës nga neni 26 paragrafi (1) i këtij ligji deri në momentin e fillimit të efektit juridik të licencës në pajtim me paragrafin (4) të këtij neni, organi i administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e veprimtarive në fushën e mjedisit jetësor, në bazë të kërkesës së personit juridik ose fizik, mund të lëshojë leje për shfrytëzim të përkohshëm të ujit nga i njëjti trup ujqor, të cilit i referohet neni 26 paragrafi (1) i këtij ligji.

(6) Anëtarët e komisionit nga paragrafi (3) i këtij neni zgjidhen me mandat prej dy vjet me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat tjetër.

(7) Komisioni nga paragrafi (3) i këtij neni miraton rregullore për punën e tij.”

## **Neni 15**

Në nenin 45 paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

“Bashkë me kërkesën për ndryshimin dhe plotësimin e lejes në rastet nga paragrafi (1) pika 1) dhe 2) e këtij neni dorëzohet studim hidrologjik, përkatësisht raport për kërkimet e kryera hidrogeologjike, të përgatitura nga subjekt juridik i regjistruar për kryerjen e atyre veprimtarive, si dhe dokument për sigurinë e ujit, gjegjësisht vërtetim se uji përshtatet për qëllimin e lëshuar nga organi kompetent për sigurinë e ujit.”

Pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3) si vijon:

(3) Bashkë me kërkesën për ndryshimin dhe plotësimin e licencës në rastet nga paragrafi (1) pika 3) të këtij neni dorëzohet edhe:

- projekti bazë për objektet dhe impiantet për ekonomizim me ujërat, i cili përmban veçanërisht lokacionin e objektit, nënshtresat hidrologjike, llogaritjet hidraulike dhe regjimin e përdorimit të ujit, i përgatitur nga person juridik që ka licencë për projektim në pajtim me Ligjin për ndërtim,
- revizion të projektit bazë nga alineja 1 i këtij paragrafi, të hartuar nga person juridik që ka licencë për revizion në përputhje me ligjin për ndërtimin.”

Paragrafët (3) dhe (4) bëhen paragrafë (4) paragrafi (5).

## **Neni 16**

Në nenin 46 në paragrafin (1) fjala “dhjetë” zëvendësohet me fjalën “gjashtë”.

Në paragrafin (4) fjalët "gjashtë muaj" zëvendësohen me fjalët "tre muaj".

## **Neni 17**

Në nenin 49 në paragrafin (1) në pikën (3) lidhësja "i" zëvendësohet me ";", dhe pika në fund të pikës 4) zëvendësohet me lidhëzën "i".

Pas pikës 4) shtohet pikë e re 5) si vijon:

"5) rrezikohet arritja e qëllimeve mjedisore të përcaktuara për periudhën planifikuese në Planin për menaxhim me pellgjet lumore.

#### **Neni 18**

Në nenin 50 në paragrafin (2) fjalët "kompensimi i dëmit për fitim të humbur dhe" shlyhen.

#### **Neni 19**

Në nenin 51 në paragrafin (1) në pikën 2) lidhësja "i" zëvendësohet me ";", dhe në pikën 3) pika në fund të fjalisë zëvendësohet me ";".

Pas pikës 3) shtohen dy pika të reja 4) dhe 5) si vijon:

"4) nuk dorëzon të dhëna dhe llogaritje për sasinë e shfrytëzuara të ujit në pajtim me nenin 213 paragrafi (32) të këtij ligji dhe 5) nëse i bartësi i lejes nuk vepron në pajtim me nenin 49 paragrafi (5) të këtij ligji në afatin e caktuar."

Në paragrafët (3) dhe (4) fjalët "pikat 1 dhe 2", shlyhen.

#### **Neni 20**

Në nenin 52 në paragrafin (3) pika në fund të fjalisë shlyhet dhe shtohen fjalët "duke përjashtuar të drejtën e kompensimit për fitimin e humbur".

#### **Neni 21**

Në nenin 54 pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3) si vijon:

"(3) Bashkë me propozimin e arsyetuar nga paragrafi (2) i këtij neni, dorëzohet edhe studimi i fizibilitetit për arsyetimin e dhënies së koncesionit për shfrytëzimin e ujit, i përgatitur në përputhje me rregulloren për dhënien e koncesioneve dhe partneritetit publiko-privat."

Paragrafi (3) i cili bëhet paragrafi (4) ndryshohet si vijon:

"Propozimin e arsyetuar nga paragrafi (2) të këtij neni, ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor ia dorëzon Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, pas realizimit paraprak të debatit publik për studimin e fizibilitetit dhe sigurimit të mendim pozitiv nga organi i administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e veprimtarive në fushën e bujqësisë, organi i administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e veprimtarive në fushën e ekonomisë, organi i administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e veprimtarive në fushën e transportit dhe lidhjeve, organi i administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e veprimtarive në fushën e mbrojtjes, organi i administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e veprimtarive në fushën e kulturës, organi i administratës

shtetërore përgjegjës për kryerjen e veprimtarive në fushën e punëve të brendshme dhe Drejtorinë për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore."

Paragrafët (4) dhe (5) bëhen paragrafë (5) dhe (6).

## **Neni 22**

Pas nenit 54, shtohet nen i ri 54-a, si vijon:

### **"Neni 54 – a**

**Pjesëmarrja e publikut në procedurën për dhënien e koncesionit**

(1) Për të siguruar pjesëmarrjen e publikut në procedurën për dhënien e koncesionit për shfrytëzimin e ujit, studimi i fizibilitetit nga neni 54 paragrafi (3) do të publikohet në ueb faqen e organit të administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e punëve në fushën e mjedisit jetësor dhe në faqen e internetit të komunave, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit në territorin e të cilëve është dhënë koncesioni.

(2) Organi i administratës shtetërore përgjegjës për punët nga sfera e mjedisit jetësor, në afat prej 30 ditësh nga dita e publikimit të studimit të fizibilitetit organizon debat publik në të cilin detyrimisht ftohen përfaqësues të komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe qytetit të Shkupit në territorin e të cilëve është dhënë koncesioni dhe përfaqësues të shoqatave të qytetarëve të themeluara për mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetësor në zonën ku zbatohet projekti.

(3) Debati publik mbahet në komunën në territorin e së cilës është dhënë koncesioni për shfrytëzimin e ujit, ndërsa nëse procedura përfshin disa komuna, do të mbahet në vendin e caktuar nga organi i administratës shtetërore përgjegjës për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(4) Organi i administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor mban procesverbal nga debati publik në të cilin do të shprehen pjesëmarrësit, vërejtjet, mendimet dhe propozimet e pjesëmarrësve ndërsa audio ose video incizim i debatit do t' i bashkëngjitet procesverbalit.

(5) Organi i administratës shtetërore përgjegjës për punët nga fusha e mjedisit jetësor është i obliguar që në afat prej 5 ditësh nga dita e mbajtjes së debatit publik të publikojë në ueb faqen e vet procesverbalin e seancës.

(6) Organi i administratës shtetërore përgjegjës për çështjet e mjedisit jetësor në afat prej 30 ditësh nga dita e përfundimit të konsultimeve publike duhet të përgatisë raport për konsultimet e zhvilluara publike, i cili përmban përgjigje individuale ose kolektive për të gjitha vërejtjet, opinione dhe propozime në lidhje me studimin e fizibilitetit.

## **Neni 23**

Në nenin 57 në paragrafin (1) në pikën 1), në alinenë 2 numri "50" zëvendësohet me numrin "35", ndërsa në alinenë 3 numri "30" zëvendësohet me numrin "20".

#### **Neni 24**

Në nenin 58 të paragrafit (2) alineja 2 ndryshohet si vijon:

"- kompensimi vjetor i cili paguhet çdo vit në përputhje me marrëveshjen e koncesionit.”.

#### **Neni 25**

Në nenin 61 paragrafi (1) pika 2 ndryshohet si vijon: “Baza ekonomike ujore për menaxhimin e integruar të ujërave“.

#### **Neni 26**

Titulli i nenit 63 ndryshohet si vijon: “Baza ekonomike ujore për menaxhimin e integruar të ujërave”.

Në paragrafin (1) fjalët "Baza ekonomike ujore e Republikës së Maqedonisë së Veriut" zëvendësohen me fjalët "Baza ekonomike ujore për menaxhimin e integruar të ujërave".

Në paragrafin (8) fjalët "Baza ujore ekonomike e Republikës së Maqedonisë së Veriut" zëvendësohen me fjalët "Baza ekonomike ujore".

#### **Neni 27**

Në titullin e nenit 64 fjalët "të Republikës së Maqedonisë së Veriut" shlyhen.

#### **Neni 28**

Në titull dhe në nenin 65 fjalët "Baza ekonomike ujore e Republikës së Maqedonisë së Veriut" zëvendësohen me fjalët "Baza ekonomike ujore".

#### **Neni 29**

Në nenin 66 në paragrafin (4) në pikën 5) fjalët "72, 90 dhe 93" zëvendësohen me fjalët "72, 90, 92 93 dhe 94".

#### **Neni 30**

Në nenin 70 pas paragrafit (3) shtohet paragrafi i ri (4) si vijon:

"(4) Nëse plani për menaxhimin e pellgjeve lumore ndërkufitare është miratuar në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare në të cilën Republika e Maqedonisë së Veriut është palë kontraktuese, do të harmonizohet plani për menaxhimin e pellgjeve lumore në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut me planin e menaxhimit të pellgjeve lumore ndërkufitare."

## Neni 31

Në nenin 74 pas paragrafit (1) shtohet paragrafi i ri (2) si vijon:

(2) Organet e administratës shtetërore, si dhe organet e komunës, qytetit të Shkupit dhe komunave në qytetin e Shkupit, të cilat në pajtim me këtë apo me ligjin tjetër janë kompetente për kryerjen e punëve të caktuara në pajtim me Programin e masave, janë të detyruar në mënyrë të pavarur ose në përputhje dhe/ose bashkëpunim me organ tjetër kompetent, të marrin të gjitha masat e nevojshme për arritjen e objektivave mjedisore të përcaktuara me Planin”

Paragrafët (2), (3) dhe (4) bëhen paragrafë (3), (4) dhe (5).

## Neni 32

Titulli i nenit 75 ndryshon, si vijon:

"Njoftim për zbatimin e bazës ekonomike ujore, planet e menaxhimit të pellgjeve lumore dhe Programit të masave"

Në nenin 75 paragrafi (1) shtohet pika e re 1) si vijon:

“1) të paktën një herë në gjashtë vjet të njoftojë Qeverinë e Republikës së Maqedonisë për zbatimin e bazës ekonomike ujore;“.

Pikat 1), 2) dhe 3) bëhen pika 2), 3) dhe 4).

Në paragrafin (2) shtohet pika e re 1) si vijon:

“1) zbatimi i Bazës ekonomike ujore në afat prej 6 vjet nga miratimi i saj;”.

Pikat 1), 2) dhe 3) bëhen pika 2), 3) dhe 4).

## Neni 33

Në nenin 79 , paragrafi (3) ndryshon si vijon:

“Për objektet dhe instalimet që kërkojnë leje mjedisore të integruar A në përputhje me dispozitat për mjedis jetësor, leja për shkarkim do të jepet si pjesë e procedurës së lejes së integruar mjedisore dhe është pjesë e lejes së integruar mjedisore në të cilën detyrimisht shënohen kushtet për mbrojtjen dhe menaxhimin e ujërave pas mendimit të siguruar paraprakisht nga organi ekspert përgjegjës për menaxhimin e ujërave.”

Paragrafët (4) dhe (5) ndryshohen si më poshtë:

“Për objektet dhe instalimet për të cilat është e nevojshme të sigurohet leje mjedisore e integruar B, organi përgjegjës për dhënien e lejes së integruar mjedisore B, duhet të marrë mendim nga autoriteti kompetent për dhënien e lejes për shkarkimin e ujërave, i cili do të sigurojë kushtet për shkarkim të cilat duhet të inkorporohen si kushte në lejen mjedisore të integruar B.

Organi që lëshon lejen mjedisore të integruar B është i detyruar të njoftojë organin që lëshon lejen për shkarkim, se kushtet e mendimit të përmendur në paragrafin (4) janë inkorporuar në lejen mjedisore të integruar B të lëshuar në përputhje me dispozitat për mjedis jetësor.”

### **Neni 34**

Në nenin 80 në paragrafin (7) alineja 4 pas fjalës "sistem" shtohen fjalët "jo më i vjetër se gjashtë muaj".

### **Neni 35**

Ne nenin 82 paragrafi (2) ndryshon si vijon:

“Kundër aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, si dhe kushteve të përcaktuara në lejen nga paragrafi (1) i këtij neni, në pajtim me rregulloret për procedurë të përgjithshme administrative, mund të parashtrahet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes, përkatësisht nga dita e botimit të lejes në librin e ujit”.

### **Neni 36**

Neni 84 ndryshon si vijon:

(1) Leja nga neni 79 paragrafi (1) i këtij ligji mund të ndryshohet ose plotësohet sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të bartësit të lejes nëse ndryshon:

- 1) sasia dhe/ose cilësia e ujërave që shkarkohen ose
- 2) sasia dhe/ose cilësia e trupit uJOR në të cilin shkarkohen ujërat, ose
- 3) procesi teknologjik i punës.

(2) Kërkesës për ndryshimin e lejes së shkarkimit në rastet nga paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të këtij neni i bashkëngjitet studim hidrologjik i trupit uJOR në të cilin janë bërë shkarkimet, i përgatitur nga person juridik i regjistruar për të kryer atë veprimtari, si dhe dokument nga seria e fundit e analizave laboratorike të ujërave të zeza, jo më e vjetër se gjashtë muaj.

(3) Bashkë me kërkesën për ndryshimin dhe plotësimin e licencës në rastet nga paragrafi (1) pika 3) të këtij neni dorëzohet edhe:

- projekti bazë për objektet dhe impiantet e ekonomisë ujore të zhvilluar nga një person juridik që ka licencë projektimi në përputhje me ligjin për ndërtimin,

- revizion i projektit bazë nga alineja 1 i këtij paragrafi, i hartuar nga person juridik që ka licencë për revizion në përputhje me ligjin për ndërtimin.

(4) Organi i administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor i regjistron ndryshimet dhe plotësimet në lejen e shkarkimit në librin ujqor.

(5) Kërkesë për ndryshimin dhe plotësimin e lejes për shkarkim nga paragrafi (1) i këtij neni mund të kërkojë organi i administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, organi i administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e veprimtaritë në fushën e bujqësisë, organi i administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e veprimtarive në fushën e shëndetësisë, si dhe një organ tjetër që ka kompetenca në lidhje me sasinë dhe/ose cilësinë e ujit të përdorur, përfshirë subjektet që në bazë të autoritetit publik kryejnë veprimtari që kanë të bëjnë me cilësinë dhe/ose sasinë e ujit që përdoret.”.

### **Neni 37**

Në nenin 85 në paragrafin (1) fjala “dhjetë” zëvendësohet me fjalën “gjashtë”.

Në paragrafin (3) fjala “gjashtë” zëvendësohet me fjalën “tre”.

### **Neni 38**

Në nenin 87 në paragrafin (7) fjalët "Komisioni Shtetëror për vendimmarrje në procedurë administrative dhe procedurën e marrëdhënies së punës në shkallë të dytë" zëvendësohen me fjalët "në pajtim me dispozitat për procedurë të përgjithshme administrative".

### **Neni 39**

Në nenin 89 në paragrafin (3) pika në fund të fjalisë shlyhet dhe shtohen fjalët "duke përjashtuar të drejtën e kompensimit për fitimin e humbur".

### **Neni 40**

Në nenin 90 në paragrafin (7) në pikën 5) lidhëza "dhe" në fund të fjalisë zëvendësohet me ";", ndërsa në pikën 6) pika në fund të fjalisë zëvendësohet me lidhëzën "dhe".

Pas pikës 6) shtohet pikë e re 7) si vijon:

“7) sigurimi i rrjedhës ekologjike në trupat ujqorë.”

### **Neni 41**

Neni 95 ndryshon si vijon:

(1) Me përjashtim, nga qëllimet mjedisore mund të reterohet përkohësisht, me kusht që të mos ketë përkeqësim të mëtejshëm të qëllimeve të cilësisë së trupit uJOR për shkak të:

- mos realizimit teknik që konsiston në devijimin për shkak të mos pasjes së qasjes dhe mungesës së masave dhe kohës për arritjen e qëllimeve të mjedisit jetësor;
- aspektet mjedisore që kanë të bëjnë me kapacitetin natyror për pastrim dhe konsiston në devijimin për shkak të kohës së nevojshme për arritjen e objektivave mjedisore pavarësisht zbatimit të masave;
- shpenzime jo proporcionale që nënkupton devijim sepse sipas analizave të kryera për rentabilitetin ekonomik, arritja e qëllimeve do të ishte në mënyrë disproporcionale e shtrenjtë;
- forca madhore dhe ngjarje emergjente që nënkupton devijimin e përkohshëm nga qëllimet mjedisore si rezultat i një ngjarjeje natyrore të jashtëzakonshme dhe të paparashikueshme ose forcë madhore siç janë përmytjet ekstreme dhe thatësira të zgjatura (të shkaktuara nga ndryshimet klimatike) ose rezultat i rrethanave që kanë të bëjnë me ngjarje të pa parashikuara të cilat nuk kanë mundur të parashihen në mënyrë të arsyeshme;
- për shkak të interesit publik ose të përgjithshëm që nënkupton devijimin nga qëllimet e mjedisit jetësor për shkak të arritjes së një interesit më të lartë publik dhe/ose të përgjithshëm dhe/ose për shkak se përfitimet për mjedisin jetësor dhe shoqërinë në arritjen e qëllimeve të përcaktuara me këtë ligj, janë më të ulëta për jetën dhe shëndetin e njeriut, sigurinë apo zhvillimin e qëndrueshëm.

(2) Gjatë përcaktimit të devijimit nga objektivat mjedisore nga paragrafi (1) i këtij neni për trupin uJOR konkret në planin e menaxhimit të pellgjeve lumore, duhet pasur kujdes që devijimi të mos jetë i përhershëm dhe të pengohet ose pamundësohet arritja e objektivave mjedisore të përcaktuara me këtë ligj, për trupin uJOR konkret dhe trupat e tjerë uJORë.

(3) Të dhënat dhe shpjegimi për devijimin nga qëllimet e mjedisit jetësor nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, si dhe masat e planifikuara dhe të ndërmarra për përmirësimin e cilësisë së ujit dhe përmbushjen e qëllimeve të mjedisit jetësor përcaktuar me këtë ligj, janë pjesë përbërëse e planit të menaxhimit të pellgjeve lumore për çdo periudhë planifikuese.

(4) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të ministrit që udhëheq me organin e administratës shtetërore përgjegjës për çështjet e mjedisit jetësor, në mënyrë të hollësishme do t'i përcaktojë rastet nga paragrafi (1) i këtij neni si dhe kushtet dhe procedura për reterim nga qëllimet për mjedisin jetësor.”

## **Neni 42**

Në nenin 96 , paragrafi (8) ndryshon si vijon:



"Formën dhe përmbajtjen e regjistrit nga paragrafi (5) i këtij neni, i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor..“

#### **Neni 43**

Në nenin 99 në paragrafin (3) në alinea 1 pas fjalës "në fushën" shtohet fjala "teknike".

#### **Neni 44**

Në nenin 105 pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (2) si vijon:

"(3) Përdorimi i plehrave artificial, produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe produkteve biocide do të bëhet në përputhje me zonimin e liqeneve natyrorë dhe rezervuarëve."

#### **Neni 45**

Në nenin 108 , paragrafi (3) ndryshon si vijon:

“Objektet dhe stabilimentet nga paragrafi (1) i këtij neni nuk mund të ndërtohen ose të fillojnë të funksionojnë nëse nuk është siguruar leje e integruar mjedisore, mendim apo pëlqim, gjegjësisht nëse nuk janë marrë masa për parandalimin dhe kontrollin e avarive me praninë e substancave të rrezikshme në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor ose dispozitë tjetër nëse parandalimi dhe kontrolli i avarive rregullohet me ligj të veçantë. “

#### **Neni 46**

Në nenin 111, paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"Me qëllim të mbrojtjes së ujërave nëntokësore, ndalohet çdo shkarkim i drejtpërdrejtë i materieve prioritare, substancave ndotëse dhe substancave të përcaktuara në pajtim me nenin 92 të këtij ligji."

Në paragrafin (2) pas fjalëve "substancë" shtohen fjalët "vendosja e materieve ndotëse në ujërat nëntokësore".

Paragrafi (3) ndryshon si vijon:

“Me përjashtim nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, leja e shkarkimit mund të lejojë shkarkimin e materieve dhe substancave nga paragrafi (1) i këtij neni për ri-injektim në të njëjtin akuifer të ujërave që përdoren për qëllime gjeotermale, ujëra që pompohen nga miniera dhe gurore ose uji i pompuar gjatë punimeve të ndërtimit dhe në raste të tjera specifike të rregulluara në përputhje me paragrafin (7) të këtij neni."

Në paragrafin (4) fjalët "paragrafi (8) i këtij neni" zëvendësohen me fjalët "neni 98 i këtij ligji".

Në paragrafin (9) fjalët "drejtpërdrejt dhe indirekt", si dhe fjalët "për marrjen e lejeve nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni", shlyhen.

#### **Neni 47**

Në nenin 114 në paragrafin (1) në pikën 1) pas fjalës "vendi" shtohen fjalët "për aglomerate".

#### **Neni 48**

Në titullin e nenit 120 fjalët "Minimumi i pranueshëm" zëvendësohen me fjalën "ekologjike".

Në paragrafin (1) fjalët "minimumi" zëvendësohen me fjalën "ekologjike".

Në paragrafin (1) në pikën 4) fjalët "neni 94" zëvendësohen me fjalët "nenet 90, 92 dhe 93".

Në paragrafin (2) fjalët "minimumi i pranueshëm" zëvendësohen me fjalën "ekologjike".

Në paragrafin (4) fjalët "Organi i administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor" zëvendësohen me fjalët "Organi i administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e punëve nga sfera e punëve hidrometeorologjike".

#### **Neni 49**

Në nenin 123 në paragrafin (2) fjalët "ekonomitë ujore nga neni 191" zëvendësohen me fjalët "objektet dhe impiantet ekonomike ujore nga neni 163 paragrafi (1) pika 1)".

Në paragrafin (4) fjalët " ekonomitë ujore të përmendura në nenin 191" zëvendësohen me fjalët " personat juridikë që administrojnë objektet dhe impiantet e ekonomisë ujore nga neni 163 paragrafi (1) pika 1). “

#### **Neni 50**

Në nenin 126 paragrafi (1) fjalët “ekonomia ujore nga neni 191” zëvendësohen me fjalët "personat juridikë që menaxhojnë objektet dhe impiantet për ekonomizim me ujë nga neni 163 paragrafi (1) pika 1)“.

Në paragrafin (6) fjala “ekonomi ujore” zëvendësohet me fjalën “personat juridik që menaxhojnë objektet dhe impiantet për ekonomizim me ujë nga neni 163 paragrafi (1) pika 1) të këtij ligji“.

#### **Neni 51**

Në nenin 130, paragrafi (4) ndryshon si vijon:

"Raportimi për gjendjen nga paragrafi (1) i këtij neni bëhet në pajtim me dispozitat për mbrojtje dhe shpëtim“.

Paragrafi (5) ndryshon si vijon:

"Organi i administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e punimeve hidrometeorologjike, përpara shfaqjes së niveleve kritike të ujit për zonën e mbrojtur, informon qendrën e menaxhimit të krizave për të dhënë një parashikim për kohën e mbërritjes dhe lartësinë e valëve të përmytjes."

#### **Neni 52**

Në nenin 131 paragrafi (1) në pikën 3) fjala "hedh" zëvendësohet me fjalën "shkarkon".

Pas paragrafit (2) shtohet paragrafi i ri (3) si vijon:

"(3) Organi i administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e punëve të mjedisit jetësor, pëlqimin nga paragrafi (2) pika 3) të këtij neni e jep në bazë të propozim - vendimit të dorëzuar, të cilit i bashkëngjitet:

- studimi hidrologjik i rrjedhës ujore, i përgatitur nga person juridik që ka licencë projektimi në përputhje me Ligjin për ndërtim,
- plan sintetik në përmasa 1: 1000, me pozicionim koordinativ dhe
- prerje tërthore me gjerësi të zonës bregore të rrjedhës ujore."

#### **Neni 53**

Titulli i pikës 5. të kreut V. ndryshohet si vijon "Mbrojtja dhe përmirësimi i regjimit të ujërave".

#### **Neni 54**

Titulli i nenit dhe neni 142 ndryshon si vijon:

" Mbrojtja dhe përmirësimi i regjimit ujq të trupave ujqorë sipërfaqësorë

(1) Mbrojtja dhe përmirësimi i regjimit ujq të trupave ujqorë sipërfaqësorë kryhet me rregullimi e shtretërve dhe brigjet e trupave ujqorë sipërfaqësorë, përkatësisht rrjedhat ujqore, liqenet dhe rezervuarët.

(2) Organet kompetente për mbrojtjen dhe përmirësimin e regjimit ujq të trupave ujqorë sipërfaqësorë nga paragrafi (1) i këtij neni janë:

- Shoqëria Aksionare, Ekonomia Ujqore e Republikës së Maqedonisë së Veriut në fushën e veprimt të saj,
- personat juridik që menaxhojnë objektet dhe impiantet për ekonomizim me ujë nga neni 163 paragrafi (1) pika 1) të këtij ligji, dhe
- njësitë e vetëqeverisjes lokale në zonat urbane.

(3) Rregullimi i shtretërve të lumenjve dhe i brigjeve të trupave ujqorë sipërfaqësorë bëhet në bazë të lejes së organit ekspert në pajtim me nenin 142-a të këtij ligji.

(4) Rregullimi i shtretërve të lumenjve dhe brigjeve të trupave ujqorë sipërfaqësorë kryhet në bazë të pëlqimit të lëshuar për ekonomi ujqore, në pajtim me nenin 174 të këtij ligji.

(5) Aktivitete për rregullimin e shtretërve të lumenjve dhe brigjeve të trupave ujore sipërfaqësore nga paragrafi (1) i këtij neni mund t'i kryejnë personat juridikë të cilët kanë leje ndërtimi në pajtim me Ligjin për ndërtim”.

## Neni 55

Titulli i nenit dhe neni 142-a ndryshon si vijon:

"Dokumentacioni i nevojshëm për lëshimin e lejes për rregullim në shtretërit dhe brigjet e trupave ujorë sipërfaqësorë

(1) Leja për rregullimin e shtretërve të lumenjve dhe brigjeve të trupave ujorë sipërfaqësorë lëshohet në bazë të kërkesës së paraqitur për marrjen e lejes të cilën parashtruesi ia paraqet organit ekspert.

(2) Me lejen nga paragrafi (1) i këtij neni përcaktohet vendndodhja, mënyra, objektet dhe mjetet, si dhe koha e rregullimit, e cila nuk mund të jetë më e gjatë se dy vjet.

(3) Kërkuesi në shtojcë të kërkesës për rregullimin e shtretërve të lumenjve dhe brigjeve të rrjedhave ujore nga paragrafi (1) i këtij neni, duhet të dorëzojë edhe dokumentacionin në vijim:

- dokumentacion teknik (projektimi bazë, rishikimi i projektit bazë dhe raporti gjeodezik) i cili përmban veçanërisht llogaritjet hidrologjike dhe hidraulike për ujërat e mëdha dhe të vogla dhe ujërat nëntokësore, gjurmën, nivelet, profilin hidraulik të rrjedhës ujore ose një pjesë të tij që paraqet tërësi rregulluese; sasinë e sedimentit, vendin për depozitimin e materialit lumor dhe të dhëna të tjera të rëndësishme për regjimin ujor dhe për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit dhe natyrës;
- hartë topografike në shkallën 1: 25.000, me pozicionim të koordinuar në vendin ku kryhet mirëmbajtja dhe rregullimi i trupit ujor sipërfaqësor;
- vlerësimi vjetor i rrjedhës në pajtim me nenin 133 të këtij ligji;
- rishikimi i projektit bazë nga alineja 1 i këtij paragrafi i punuar nga personi juridik i cili ka licencë për revizion në pajtim me Ligjin për ndërtim dhe
- aktvendim për studimin e miratuar për vlerësimin e ndikimit mbi mjedisin, përkatësisht vendim për miratimin e elaboratit për mbrojtjen e mjedisit të nxjerrë nga organi kompetent në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor.

(4) Nëse bëhet fjalë për rregullimin e brigjeve të liqeneve dhe rezervuarëve, dokumentacioni teknik nga paragrafi (3) alineja 1 i këtij neni, veçanërisht përmban regjim të lëkundjeve të nivelit të ujit, sasisë së sedimentit, ndikimi i stabilitetit bregor dhe të dhëna të tjera që janë të rëndësishme për regjimin ujor dhe për mbrojtjen dhe promovimin e mjedisit dhe natyrës.

(5) Aktvendimi për miratimin e elaboratit për mbrojtjen e mjedisit jetësor nga paragrafi (3) alineja 5 të këtij neni të cilin e nxjerr komuna, komunat e qytetit të Shkupit ose qyteti i Shkupit, në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor, i siguron personi zyrtar i autorizuar në organin e administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e punëve nga sfera e

mjedisit jetësor, i cili e zhvillon procedurën për dhënien e lejes për rregullimin e shtretërve dhe brigjeve të rrjedhave ujore, e cila është e detyruar që afat prej tre ditë nga dita e marrjes së kërkesës të kërkojë dokumentacionin nga organi publik kompetent.

(6) Aktvendimi për studimin e miratuar për vlerësimin e ndikimit mbi mjedisin jetësor, të nxjerrë nga organi i administratës shtetërore përgjegjës për punët e mjedisit jetësor, përkatësisht aktvendimi për miratimin e elaboratit për mbrojtjen e mjedisit të nxjerrë nga organi i administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e të punëve profesionale nga fusha e mjedisit jetësor në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor, nga paragrafi (3) alineja 5 i këtij neni, personi zyrtar i autorizuar në organin e administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor mban procedurë për lëshimin e lejes për rregullimin e shtretërve dhe brigjeve të lumenjve të rrjedhave ujore, i siguron nga evidenca zyrtare e organit.

(7) Personi zyrtari i autorizuar nga organi publik kompetent është i obliguar që në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës t'i dorëzojë dëshmitë e kërkuara nga paragrafi (3) i këtij neni.

(8) Leja nga paragrafi (1) i këtij neni evidentohet në librin uhor nga neni 160 i këtij ligji.

(9) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore përgjegjës për çështjet e mjedisit jetësor i përcakton formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës dhe lejes nga paragrafi (1) i këtij neni.

## Neni 56

Pas nenit 142-a shtohet neni i ri 142-b si vijon:

### “Neni 142-b

Procedura për lëshimin e lejeve për rregullimin e shtretërve dhe brigjeve të trupave ujorë sipërfaqësorë

- (1) Organi profesional është i detyruar që pa vonesë ta publikojë në faqen e tij të internetit dhe nga një kopje të kërkesës t'ua dorëzojë organeve të administratës shtetërore dhe institucioneve të tjera që preken nga veprimtaritë që do të kryhen në vendndodhjen e subjektit.
- (2) Subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni janë të obliguar në afat prej 15 ditësh nga pranimi i kërkesës t'i paraqesin mendim organit profesional.
- (3) Nëse subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni nuk japin mendim në afatin e përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni, konsiderohet se janë pajtuar me kërkesën.
- (4) Organi ekspert nga paragrafi (1) i këtij neni është i obliguar që në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës të marrë vendim për dhënien e licencës, përkatësisht

për refuzimin e kërkesës për lëshimin e licencës për rregullimin e shtretërve të lumenjve dhe brigjeve të rrjedhave ujore.

- (5) Kundër aktvendimit nga paragrafi (4) i këtij neni mund të parashtrohet ankesë në pajtim me dispozitat për procedurë të përgjithshme administrative në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, gjegjësisht nga dita e publikimit të lejes në librin e ujërave."

### **Neni 57**

Në titullin e nenit 142-c, fjala "leje" zëvendësohet me fjalët "lejet për rregullim".

- (1) Ekonomitë ujore dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale të cilave u është lëshuar leja për rregullim të shtretërve të lumenjve dhe brigjeve të rrjedhave ujore, janë të detyruar t'u përmbahen kushteve në lejen.
- (2) Ekonomitë ujore dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale të cilave u është lëshuar leja për rregullimin e shtretërve të lumenjve dhe brigjeve të rrjedhave ujore, ku parashihet edhe nxjerrja e rërës, zhavorrit dhe gurit janë të obliguar të mbajnë ditar në të cilin evidentohen sasia e nxjerrë e rërës, zhavorrit dhe gurit në baza ditore, vendndodhja prej nga është nxjerrë ai material, koha e nxjerrjes së materialit dhe lloji i mekanizimit.
- (3) Mbjajtësit e lejes për rregullim të shtretërve të lumenjve dhe brigjeve të rrjedhave ujore janë të detyruar t'i paraqesin organit të administratës shtetërore përgjegjës për çështjet e mjedisit jetësor, raport gjeodezik për aktivitetet e kryera, të përgatitur nga person juridik që posedon licencë në fushën e gjeodezisë, për çështjet e mjedisit, brenda tre muajve nga data e përfundimit të aktiviteteteve.
- (4) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore përgjegjës për çështjet e mjedisit jetësor e përcakton formën dhe përmbajtjen e formularit dhe mënyrën e mbajtjes së ditarit nga paragrafi (2) i këtij neni.

### **Neni 58**

Titulli i nenit dhe neni 142-d ndryshon si vijon:

“Veprimi me materialin e nxjerrë gjatë rregullimit të shtretërve të lumenjve dhe brigjeve të trupave ujqorë sipërfaqësorë

- (1) Gjatë rregullimit të shtretërve dhe brigjeve të trupave ujqorë sipërfaqësorë, materiali i nxjerrë mund:
  - të vendoset / shpërndahet në të njëjtin trup ujqor pa tërhequr brigjet;
  - të përdoret për objekte mbrojtëse të ekonomisë ujqore ose për mbrojtje të rregullt ose emergjente nga përmytjet, me ose pa nxjerrje paraprake nga bregu;
  - të përdoret për ndërtimin e objekteve dhe kryerjen e punëve me rëndësi për Republikën e Maqedonisë së Veriut, me ç'rast bartësit e lejes do t'i kompensohen shpenzimet e nxjerrjes, transportit, asgjësimit dhe ruajtjes së materialit.

- (2) Materiali i nxjerrë i cili nuk do të përdoret në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, mund të shitet në treg të hapur, me ankand publik, me ç' rast çmimi i shitjes së materialit nuk mund të jetë më i ulët se çmimi i shitjes së materialit në treg i përcaktuar në përputhje me rregulloret në fushën e lëndëve të para minerale.
- (3) Në rastet nga paragrafi (1) alineja 3 dhe paragrafi (2) i këtij neni, mbajtësi i lejes është i obliguar që materialin e larguar ta deponojë në deponi në përputhje me dokumentacionin teknik.
- (4) Për sasinë e materialit nga paragrafi (3) i këtij neni, i cili transportohet në deponi, organi administrativ përgjegjës për punët e mjedisit jetësor lëshon dhe vërteton fletëdorëzimin dhe dokumentin për deponimin e materialit.
- (5) Fletëdërgesa nga paragrafi (3) i këtij neni, i lëshohet bartësit të licencës në sasi të përcaktuara me lejen dhe çdo person i cili transporton rërë, zhavorr dhe gurë është i detyruar ta ketë në momentin e transportit.
- (6) Për fletë dërgesat e lëshuar dhe të vërtetuara nga paragrafët (4) dhe (5) të këtij neni, organi i administratës shtetërore përgjegjës për punët në fushën e menaxhimit të ujërave mban evidencë në regjistrin e fletë dërguesve të lëshuar dhe të vërtetuara.
- (7) Formën dhe përmbajtjen e faturave, formën dhe përmbajtjen e regjistrit të faturave të lëshuara dhe të certifikuara e përcakton ministri që drejton organin e administratës shtetërore përgjegjës për punët në fushën e ekonomizimit me ujërat.
- (8) Dispozitat e këtij neni do të zbatohen edhe gjatë lëshimit të pëlqimit për ekonomi ujore për rregullimin e shtretërve të lumenjve dhe brigjeve të trupave ujorë sipërfaqësorë, në pajtim me nenin 174 të këtij ligji."

#### **Neni 59**

Në nenin 144 në paragrafët (1), (2) dhe (3) fjalët "dhe të ujërave të dedikuar për shfrytëzim," shlyhen.

#### **Neni 60**

Në nenin 145 në paragrafin (4) fjala ministër zëvendësohet me fjalët "Me propozimin e organit të administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e punëve nga fusha e punëve hidrometeorologjike, ministri".

#### **Neni 61**

Në nenin 146, paragrafi (1) ndryshon si vijon:

"Organi i administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e veprimtarive në fushën e punëve hidrometeorologjike është përgjegjës për monitorimin e përgjithshëm të trupave ujorë që janë të përfshira nga rrjeti shtetëror, si dhe për realizimin, funksionimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetit shtetëror."

Paragrafi (3) shlyhet.

Paragrafët (4) dhe (5) bëhen paragrafë (3) dhe (4).

Në paragrafin (6) i cili bëhet paragrafi (5) fjalët "dhe së paku një person me arsim të lartë në fushën e mbrojtjes shëndetësore" shlyhen.

Në paragrafin (7), i cili bëhet paragrafi (6) pas fjalës shëndetësi, shtohen fjalët "dhe organit të administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e veprimtarive në fushën e bujqësisë".

#### **Neni 62**

Në nenin 148, paragrafi (11) ndryshon si vijon:

"Organit të administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e punëve në fushën e shëndetësisë është i detyruar të përgatisë raporte vjetore për gjendjen e ujërave të destinuara për konsum njerëzor dhe t'i publikojë në faqen e tij të internetit".

#### **Neni 63**

Në nenin 150 në paragrafin (8) fjalët "çdo dy vjet" zëvendësohen me fjalën "çdo vit".

#### **Neni 64**

Në nenin 155 në paragrafin (1) fjalët "dhe personat fizik" shlyhen.

#### **Neni 65**

Në nenin 161, paragrafi (5) ndryshon si vijon:

"Kadastra e ndotësve është e qasshme për publikun në faqen e internetit të organit të administratës shtetërore përgjegjëse për kryerjen e veprimtarive në fushën e mjedisit."

#### **Neni 66**

Neni 162 në paragrafin (2) fjala "ndërshtetërore" zëvendësohet me fjalën "ndërkufitare".

#### **Neni 67**

Në nenin 163 në paragrafin (1) në pikën 1) pas fjalës "hapësirat" shtohet fjala "hidrosterilat".

#### **Neni 68**

Në nenin 164 paragrafi (2) pika 8) ndryshohet si vijon:

"rregullimi i shtretërve të lumenjve dhe brigjeve të trupave ujqorë sipërfaqësorë dhe".

#### **Neni 69**

Në nenin 165 pas paragrafit (2) shtohet paragrafi i ri (3) si vijon:



“Personi juridik ose fizik që kap ujë nga trupat ujorë sipërfaqësorë është i detyruar të sigurojë lëvizjen e papenguar të peshqve, për të cilin duhet të ngrejë dhe mirëmbajë në gjendjen e duhur impiantet (shtigjet e peshkut) përkatëse, në përputhje me praktikat ose teknikat më të mira në dispozicion. ”

Paragrafët (3) dhe (4) bëhen paragrafë (4) paragrafi (5).

#### **Neni 70**

Në nenin 166 në paragrafin (2) pas fjalëve "mbi ujërat" shtohen fjalët "dhe ekosistemet ujore".

Në paragrafin (3) pas fjalëve "mjedisi jetësor" shtohen fjalët "dhe Qendra për Menaxhimin e Krizave".

#### **Neni 71**

Në nenin 167 në paragrafin (1) në pikën 8) pas fjalës "shkarkojnë" shtohet fjala "të pa trajtuara".

#### **Neni 72**

Në nenin 174, paragrafi (5) ndryshon si vijon:

“Për objektet për të cilat është paraparë leje për shfrytëzim, përkatësisht shkarkim në ujë, leja e lëshuar në përputhje me këtë ligj zëvendëson pëlqimin e ekonomisë ujore. “

Në paragrafin (5) i cili bëhet paragrafi (6) pas fjalës "ujë" shtohen fjalët "dhe shkarkimi i ujërave".

#### **Neni 73**

Në nenin 176, paragrafi (5) ndryshon si vijon:

“Aktvendim për studimin e miratuar për vlerësimin e ndikimit në mjedis, gjegjësisht vendim për miratimin e elaboratit për mbrojtjen e mjedisit të nxjerrë nga organi kompetent në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor”.

Paragrafët (5), (6) dhe (7) bëhen paragrafë (6), (7) dhe (8).

#### **Neni 74**

Neni 177 shlyhet.

#### **Neni 75**

Neni 179 ndryshon si vijon:

"(1) Pëlqimi i ekonomisë ujore pushon të jetë i vlefshëm nëse investitori nuk jep leje ndërtimi në afat prej një viti në pajtim me Ligjin për ndërtim.

(2) Pëlqimi i ekonomisë ujore pushon të jetë i vlefshëm me përfundimin e lejes së ndërtimit.

(3) Për objektet paragrafët (1) dhe (2) të nenit 174, për të cilat Ligji për ndërtim nuk parasheh dhënien e lejes së ndërtimit, pëlqimi ekonomik uxor pushon të vlejë pas kalimit të dy viteve nga dita e lëshimit".

#### **Neni 76**

Në nenin 183 paragrafi (4) pika në fund të fjalisë zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët "në përputhje me rregulloret në fushën e sigurisë ushqimore. ".

#### **Neni 77**

Titulli i nenit 191 ndryshohet si vijon: "Sistemet e ujitjes dhe kullimit".

Paragrafi (2) ndryshon si vijon:

"Përdorimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve hidrike apo sistemeve të ujitjes dhe kullimit e kryejnë ekonomitë ujore dhe personat e tjerë juridikë të themeluar për këtë dhe llojin e punës në përputhje me ligjin".

#### **Neni 78**

Neni 192 shlyhet.

#### **Neni 79**

Në nenin 198 pas paragrafit (3) shtohet paragrafi i ri (4) si vijon:

"Formën dhe përmbajtjen e elaboratit nga paragrafi (2) i këtij neni, e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor."

Paragrafi (4) bëhet paragraf (5).

#### **Neni 80**

Në nenin 200 në paragrafin (1) fjala "minimumi" shlyhet.

#### **Neni 81**

Në nenin 202, paragrafi (2) ndryshon si vijon:

"Në afat prej një muaji nga përfundimi i ndërtimit të pusit, hapësi i pusit përgatit dhe i paraqet një raport organit të administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e veprimtarive në fushën e mjedisit."

### **Neni 82**

Në nenin 208, paragrafi (2) ndryshon si vijon:

"Kompensimi për nxjerrjen e rërës, zhavorrit dhe gurit nuk paguhet nëse rëra, zhavorri dhe guri i nxjerrë përdoret në pajtim me nenin 142-g paragrafi 1 të këtij ligji".

### **Neni 83**

Në nenin 213 në paragrafin (13) alineja 1 fjala "prodhim" zëvendësohet me fjalën "shitje".

Paragrafi (16) ndryshon si vijon:

"Lartësia e kompensimit të paguar për ambalazhimin e ujit për nevoja komerciale është 2% e çmimit të përcaktuar të ujit në ujësjellësin publik".

Paragrafi (18) ndryshon si vijon:

"Obliguesi nga paragrafi (17) i këtij neni është i obliguar që ta paguajë kompensimin nga paragrafi (16) të këtij neni, më së voni 30 ditë nga dita e përdorimit të ujit të ambalazhuar dhe e paguan në llogari pagesore të veçantë në kuadër të llogarisë së thesarit, një herë në muaj."

Në paragrafin (23) numri "3%" zëvendësohet me numrin "1%".

Pas paragrafit (31) shtohet paragraf i ri (32) si vijon:

"Obliguesit nga ky nen për shfrytëzimin e ujit detyrohen një herë në vit në periudhën nga 01 deri më 31 mars të vitit aktual për vitin paraardhës ndaj organit të administratës shtetërore përgjegjëse për kryerjen e veprimtarive në fushën e mjedisit jetësor të dorëzojë të dhëna për kompensimet e llogaritura dhe të paguara për ujin e përdorur për vitin paraardhës."

Paragrafët (32) dhe (33) bëhen paragrafë (33) dhe (34).

### **Neni 84**

Në nenin 214 pas paragrafit (12) shtohet paragrafi i ri (13) si vijon:

(13) Obliguesit nga ky nen që shkarkojnë ujërat e zeza janë të detyruar një herë në vit në periudhën prej 1 deri më 31 mars të vitit aktual për vitin paraprak t'i paraqesin organit të administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e punëve nga fusha e mjedis jetësor të

dhëna për kompensime të llogaritura dhe të paguara për ujërat e shkarkuar për vitin paraardhës. “

### **Neni 85**

Në nenin 215, paragrafi (2) ndryshon si vijon:

"Obligues për pagesën dhe llogaritjen e kompensimit nga paragrafi (1) i këtij neni është bartësi i lejes për rregullimin dhe pëlqimin e ekonomisë ujore për rregullimin e shtretërve dhe brigjeve të trupave ujorë sipërfaqësorë që parasheh nxjerrjen e rërës, zhavorrit dhe gurit nga shtretërit dhe brigjet e trupave ujorë sipërfaqësorë. “

Pas paragrafit (5) shtohet paragraf i ri (6) si vijon:

"Obliguesi nga ky nen është i detyruar një herë në vit në periudhën nga 1 deri më 31 mars të vitit aktual për vitin paraprak t'i paraqesë organit të administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e veprimtarive në fushën e mjedisit, të sigurojë të dhëna për ka nxjerrë rërë, zhavorr dhe gurë dhe për llogaritjen e kompensimit në vitin paraardhës."

Paragrafi (6) bëhet paragrafi (7).

Në paragrafin (7) i cili bëhet paragrafi (8) në alineja 2, shenja ";" zëvendësohet me lidhëzën "i", në alineja 3 lidhësja "i" zëvendësohet me pikë ndërsa alineja 4 shlyhet.

### **Neni 86**

Në nenin 218, paragrafi (2) ndryshon si vijon:

“Realizimi i drejtpërdrejtë i mjeteve nga Programi për Menaxhimin e Ujërave kryhet nga organi i administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e veprimtarive në fushën e mjedisit jetësor”.

Në paragrafin (3) fjalët " ndërsa në bazë të raporteve të organeve nga paragrafi (1) i këtij neni " shlyhen.

Paragrafi (4) shlyhet.

Paragrafët (5), (6) dhe (7) bëhen paragrafë (4), (5) dhe (6).

### **Neni 87**

Në nenin 223 pas paragrafit (9) shtohet paragrafi i ri (10) si vijon:

"(10) Anëtarët e këshillit dhe këshillit për menaxhimin e pjesëve të zonës së pellgut lumor zgjidhen me mandat 6 vjeçar. “

Paragrafi (10) bëhet paragrafi (11).

### **Neni 88**

Në nenin 229 paragrafi (1) "dhe inspektorët shtetërorë të mjedisit jetësor" zëvendësohen me fjalët "inspektorët shtetërorë të natyrës dhe inspektorët shtetërorë të mjedisit".

### **Neni 89**

Në nenin 230 në paragrafin (1) pas pikës 4) shtohet pika e re 4-a):

"4-a) kryen kontroll dhe inspektim nëse është marrë licenca e nevojshme për aktivitetet dhe veprimtaritë në përputhje me nenet 26 dhe 28 të këtij ligji;"

### **Neni 90**

Neni 231 shlyhet.

### **Neni 91**

Në nenin 232 në paragrafin (1) në pikën 24 fjalët "minimumi i pranueshëm" zëvendësohen me fjalët "ekologjike".

### **Neni 92**

Pas nenit 232, shtohet nen i ri 232-a, si vijon:

„2.3. Inspektori Shtetëror për Mbrojtjen e Natyrës

#### **Neni 232-a**

#### **Fushëveprimi i Inspektorit Shtetëror për Mbrojtjen e Natyrës**

(1) Inspektori shtetëror për mbrojtjen e natyrës ka të drejtë të mbikëqyrë ujërat që gjenden në zonat e mbrojtura në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e natyrës dhe me këtë ligj;

(2) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori shtetëror për mbrojtjen e natyrës me aktvendim:

1. përcakton masat për eliminimin e shkaqeve të ndotjes së ujërave në zonat e mbrojtura;
2. urdhëron heqjen e pasojave të dëmshme të shkaktuara nga ndotja dhe sjelljen e ujërave në zonat e mbrojtura në gjendjen e mëparshme;
3. do të përcaktojë masat për parandalimin dhe largimin e ndotjes dhe kthimin e gjendjes së ujit në zonat e mbrojtura në gjendje të kënaqshme;
4. do të ndalojë zbatimin e aktiviteteve në zonat e mbrojtura që shkaktojnë ndotje të ujit;
5. do të ndalojë funksionimin e objekteve, impianteve dhe instalimeve, për shkak të shkarkimit të ujërave të zeza ose derdhjes së materieve dhe substancave në ujërat e zonave të mbrojtura, derisa të tejkalohen mangësitë dhe

6. do të urdhërojë eliminimin e mangësive që do të identifikojë gjatë mbikëqyrjes dhe të caktojë një afat për eliminimin e tyre;
- (3) Në kryerjen e punëve nga fushëveprimi i tij, inspektori ka të drejtë të ndërmarrë aktivitete të përcaktuara me Ligjin për mbrojtjen e natyrës dhe Ligjin për mjedisin jetësor.

### Neni 93

Në nenin 233, paragrafi (1) ndryshon si vijon:

"(1) Inspektori i autorizuar për mjedisin jetësor i komunave, komunave të qytetit të Shkupit dhe qytetit të Shkupit (në tekstin e mëtejme: inspektor i autorizuar) në territorin e komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe qytetit të Shkupit ka të drejtë të kryejë:

- 1) kontrollim dhe të konstatojë nëse për subjektet që kryejnë veprimtari dhe aktivitete që sipas Ligjit për mjedisin jetësor janë në kompetencë të komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe qytetit të Shkupit është marrë leja e nevojshme në pajtim me nenin 26 dhe 28 të këtij ligji;
- 2) kontrollim dhe të përcaktojë nëse uji përdoret në përputhje me kushtet e përcaktuara në lejen e lëshuar për përdorimit të ujit;
- 3) kontrollim dhe të konstatojë nëse me veprimin apo aktivitetin është vepruar në kundërshtim me ndalimin e përgjithshëm nga neni 77 i këtij ligji;
- 4) kontrollim dhe të konstatojë nëse personi juridik apo fizik ka leje për shkarkim (neni 79);
- 5) kontrollim dhe të konstatojë nëse ujërat shkarkohen në mënyrën dhe kushtet e përcaktuara në përputhje me lejen e shkarkimit (neni 83);
- 6) kontrollim dhe mbikëqyrje mbi mbrojtjen e zonave për larje nga ndotja dhe aktivitetet që mund të ndikojnë negativisht mbi përshtatshmërinë e ujit për larje (neni 101);
- 7) kontrollim dhe të konstatojë nëse objektet dhe impiantet që punojnë me substanca dhe materie të rrezikshme veprojnë në pajtim me nenin 108 të këtij ligji;
- 8) kontrollim dhe të konstatojë nëse shkarkimi i ujërave të zeza kryhet në pajtim me nenin 110 të këtij ligji;
- 9) kontrollim dhe të konstatojë nëse është vepruar në pajtim me nenin 111 të këtij ligji në lidhje me shkarkimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në ujërat nëntokësore;
- 10) kontrollim dhe të konstatojë nëse kryhet para-trajtimi i ujërave të zeza industriale (neni 116);
- 11) kontroll mbi sistemet e kanalizimit, sistemet e kullimit dhe gropat septike në territorin e komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe qytetit të Shkupit që derdhen në sistemet e kanalizimit (neni 113 paragrafi (3));
- 12) mbikëqyrje mbi grumbullimin, zbatimin, pastrimin dhe shkarkimin e ujërave të zeza nga efluentet shtëpiake, ujërat e rrëmbyeshëm të grumbulluar nga reshjet atmosferike në zonat urbane (neni 114);
- 13) kontrollim dhe të konstatojë nëse është siguruar rrjedha minimale e pranueshme e ujit dhe niveli i ujërave nëntokësore (neni 120);

- 14) mbikëqyrje të grumbullimit, zbatimit, trajtimit dhe shkarkimit të ujërave të zeza nga efluentet industriale nga subjektet që posedojnë leje mjedisore të integruar B ose elaborate të aprovuara për mjedis jetësor, të cilat në përputhje me Ligjin për mjedisin jetësor janë në juridiksionin e komunave, komunave në qytetin e Shkupi dhe qytetin e Shkupit;
- 15) kontrollim dhe të konstatojë nëse plani operativ për mbrojtje nga vërshimet zbatohet në territorin e komunave, komunave në Qytetin e Shkupit dhe Qytetin e Shkupit në pajtim me nenin 126 të këtij ligji;
- 16) kontrollim dhe të konstatojë nëse është vepruar në pajtim me nenin 131 të këtij ligji;
- 17) kontrollim dhe të konstatojë nëse janë ndërmarrë masa për mbrojtje nga erozioni në pajtim me nenin 137 paragrafi (1) të këtij ligji;
- 18) kontrollim dhe të konstatojë nëse janë marrë masa për rregullimin e rrëkeve (neni 141);
- 19) kontrollim dhe të konstatojë nëse janë ndërmarrë masa për mbrojtje nga rrëketë në pajtim me nenin 141 paragrafi (4) të këtij ligji;
- 20) kontrollin mbi zbatimin e monitorimit të ujit dhe dërgimin e informatave nga trupat ujorë të përfshirë nga rrjeti lokal (neni 146 paragrafi (2));
- 21) kontroll dhe inspektim nëse monitorimi i cilësisë dhe sasisë së trupave ujorë kryhet në pajtim me nenin 147 të këtij ligji;
- 22) kontroll mbi zbatimin e monitorimit të ujërave dhe dërgimin e informatave nga zonat për larje (neni 146 paragrafi (5) dhe neni 149));
- 23) kontroll mbi zbatimin e monitorimit të shkarkimit të ujërave të zeza dhe dhënien e informacioneve nga (neni 150);
- 24) kontroll dhe inspektim nëse janë dorëzuar të dhënat për mbajtjen e kadastrës së ndotësve (neni 161 paragrafi (3));
- 25) mbikëqyrje mbi ndërmarrjen e masave të nevojshme për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi efikas dhe ekonomik të furnizimit me ujë të pijshëm në sasi të mjaftueshme dhe sipas kërkesave të të gjithë përdoruesve ligjor (neni 185);
- 26) mbikëqyrje dhe kontroll të përdorimit të ujit të pijshëm dhe për larje dhe të konstatojë nëse ekziston keqpërdorim dhe shfrytëzim të papërshtatshëm të ujërave të pijshëm dhe ujërave për larje, në rajonin e tij (neni 189);
- 27) mbikëqyrje dhe kontroll mbi zbatimin e ndalimit për ujitje dhe furnizim me ujë të bagëtive (neni 193);
- 28) kontroll mbi cilësinë e ujërave të zeza të shkarkuara dhe
- 29) çështje të tjera të përcaktuara me ligj ose dispozitë tjetër.”

#### **Neni 94**

Kapitulli 2.4 ndryshohet si vijon:

„2.4. Procedimi i inspektorit të ekonomisë ujore, të inspektorit shtetëror për mjedisin jetësor, të inspektorit shtetëror për mbrojtjen e natyrës dhe të inspektorit të autorizuar për mjedisin jetësor.”

Titulli i nenit 234 ndryshon, si vijon:

“Procedimi i inspektorit të ekonomisë ujore, inspektorit shtetëror për mjedisin jetësor, inspektorit shtetëror për mbrojtjen e natyrës dhe inspektorit të autorizuar për mjedis”

Në nenin 234, paragrafi (1) ndryshon si vijon:

"Përveç dispozitave të këtij ligji, gjatë kryerjes së inspektimit, inspektori i ekonomisë ujore, inspektori shtetëror i mjedisit ose inspektori i autorizuar i mjedisit (në tekstin e mëtejshëm: inspektori) në mënyrë adekuate zbatojnë dispozitat e Ligjit për mjedisin jetësor, Ligjit për mbrojtjen e natyrës dhe Ligjit për mbikëqyrje inspektuese.”

### **Neni 95**

Në nenin 235, paragrafi (1) ndryshon si vijon:

"(1) Në kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese në kuadër të fushëveprimit të tij, inspektori sanitar-shëndetësor kryen:

- 1) kontroll dhe inspektim nëse është bërë shënimi i zonave mbrojtëse të ujit të destinuar për konsum njerëzor dhe i regjimit në zonat mbrojtëse të ujit të destinuar për konsum njerëzor (nenet 98 dhe 100);
- 2) kontroll dhe inspektim nëse është bërë shënimi i zonave për larje dhe nëse respektohet regjimi në ujërat për larje (neni 101);
- 3) kontroll të mbrojtjes dhe cilësisë së ujërave për larje dhe rekreacion (neni 104);
- 4) kontroll mbi zbatimin e dispozitave të neneve 181, 182, 183, 184, 185, 186, 187, 188, 189 dhe 190 të këtij ligji që kanë të bëjnë me ujërat e destinuara për konsum njerëzor;
- 5) kontroll mbi zbatimin e monitorimit të ujërave të destinuara për konsum nga njerëzit dhe dhënien e informatave (neni 146 paragrafi (4) dhe neni 148) dhe
- 6) kontroll dhe inspektim nëse monitorimi i cilësisë dhe sasisë së trupave ujorë kryhet në pajtim me nenin 147 të këtij ligji."

### **Neni 96**

Në nenin 237, paragrafi (1) ndryshon si vijon:

(1) Inspektori shtetëror për bujqësi, gjatë kryerjes së inspektimit nga fushëveprimi i tij, ka të drejtë të kryejë:

- 1) kontrollon dhe të konstatojë nëse rekomandimet për praktikë të mirë bujqësore zbatohen në zonat e ndjeshme ndaj nitrateve (neni 102 paragrafi (1));
- 2) kontroll dhe të konstatojë nëse janë zbatuar masat e përcaktuara në planin operativ për mbrojtjen e ujërave nga ndotja e shkaktuar nga nitratet nga burimet bujqësore (neni 102 paragrafi (3));



- 3) kontrollon dhe të konstatojë nëse plehurat artificiale, produktet për mbrojtjen e bimëve dhe produktet biocide përdoren në kundërshtim me nenin 105 paragrafi (2) të këtij ligji;
- 4) kontroll mbi zbatimin e monitorimit të ujit për ujitje (neni 151);
- 5) kontroll mbi zbatimin e monitorimit të ujërave për kullimin e tokës (neni 152);
- 6) kontroll dhe inspektim nëse monitorimi i cilësisë dhe sasisë së trupave ujorë kryhet në pajtim me nenin 147 të këtij ligji;
- 7) kontrolloj të aktiviteteteve dhe veprimtarive të ekonomive ujore nga neni 191 i këtij ligji dhe
- 8) nëse respektohet ndalimi i përdorimit ose shfrytëzimit të ujit për ujitje dhe për bagëtitë (neni 193)."

#### **Neni 97**

Dispozita më të afërta për zbatimin e këtij ligji do të miratohen brenda një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

#### **Neni 98**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

## **ARSYETIM I PROPOZIM LIGJIT PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR UJËRAT**

### **I. SHPJEGIMI I PËRMBAJTJES SË DISPOZITAVE TË PROPOZIM LIGJIT**

Me ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për ujërat, bëhen ndryshime në dispozitat në Ligjin për ujërat me qëllim të lehtësimit dhe zbatimit më të mirë të ligjit.

Në nenin 4, ku përcaktohen përkufizimet e ligjit, bëhen ndryshime dhe plotësime në ligj më saktë bëhet përcaktimi plotësues i përkufizimeve të caktuara të ligjit.

Në nenin 6 bëhet saktësimi plotësues i nenit.

Në nenin 7 shtohet paragrafi i ri (4) me të cilin rregullohet obligimi i organeve të administratës shtetërore që në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me organet tjera të ndërmarrin aktivitete në pajtim me Programin e Masave.

Në nenet 9, 10, 37, bëhet saktësim plotësues i terminologjisë përkatësisht në vend të ndërkombëtar, specifikohet me "ndërkufitar". Gjithashtu, shtohen edhe përkufizime të reja për "rrjedhë ekologjike" dhe "përmbytje".

Ndryshimet dhe plotësimet në nenin 17 synojnë të përcaktojnë saktësisht mënyrën se si ujërat nëntokësore mund të përdoren për nevoja personale dhe shtëpiake. Konkretisht, me ndryshimet dhe plotësimet e ligjit vendoset detyrimi për paraqitjen e kërkesës në Drejtorinë e Mjedisit Jetësor pranë Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor dhe specifikohen në mënyrë të detajuar dokumentet që duhet të dorëzohen krahas kërkesës.

Në nenin 21 i shtohet një paragraf i ri (3), i cili përcakton se ujërat nëntokësore të cilat, në bazë të lejes për shfrytëzimin e ujit, përdoren për ngrohje përmes thithjes së energjisë termike, duhet të kthehen në të njëjtin trup nga i cili janë kapur në mënyrë dhe nën kushtet në pajtim me lejen.

Në nenin 28 kryhet përmirësimi dhe sqarimi i tekstit të ligjit se për objektet dhe instalimet që kërkojnë marrjen e lejeve të integruara mjedisore, leja do të merret në përputhje me dispozitat e Ligjit për mjedisin jetësor si rregullore që rregullon dhënien e lejeve të integruara mjedisore.

Neni 29 bën që fjalët objekt ndërtimi dhe parcelë ndërtimore të zëvendësohen me fjalët parcelat fqinje për zbatim më të qartë të nenit.

Në nenin 30 kryhet plotësim në lidhje me përdorimin e ujërave nëntokësore për thithjen e energjisë termike, kërkuesi i lejes paraqet edhe projekt për riinjektim. Nëse paraqitet kërkesa për shfrytëzimin e ujit për kërkime hidrogjeologjike për mbledhjen e të dhënave, kërkuesi paraqet raport për kryerjen e hulumtimeve hidrogjeologjike dhe hartë topografike në përmasa 1:25.000, me pozicionim të koordinuar në terrenin e kërkimit.

Në nenin 33 shtohen dy pika 33, të cilat ndryshojnë paragrafin dhe vendosin detyrimin për paraqitjen e kërkesës për dhënie leje personave juridikë përgjegjës për furnizimin me ujë për konsum njerëzor, për zonat për të cilat janë marrë masa mbrojtëse në pajtim me nenin 98 të këtij ligji dhe personat juridikë dhe fizikë të cilët në pajtim me rregulloret për mbrojtjen e natyrës janë përgjegjës për menaxhim me zonat e mbrojtura.

Në nenet 38 dhe 40 bëhet rregullimi teknik i anëtarëve.

Në nenin 41, ndryshimet e nenit synojnë të qartësojnë fillimin e efektit juridik të lejes. Në nenin është rregulluar që leja fillon me efekt juridik pas marrjes së konfirmimit për inspektimin e kryer të objekteve dhe impianteve për përmbushjen e kushteve. Inspektimi

i objekteve dhe impianteve që i përkasin kategorisë së parë kryhet në përputhje me dispozitat për ndërtim, ndërsa për ato që i përkasin kategorisë së dytë kryhet nga një komision i formuar nga MMJPH.

Me ndryshimet dhe plotësimet në nenin 45 specifikohet se në cilat raste leja ndryshohet dhe dokumentet e nevojshme që kërkohen për ndryshimin e lejes për të drejtën ujore.

Në nenin 46 bëhet ndryshim në lidhje me kohëzgjatjen e licencës dhe ajo lëshohet në vend për dhjetë vjetëve në jo më shumë se gjashtë vjet.

Në nenin 49, bëhet plotësim i nenit në rastet kur mund të kryhet kufizimi i së drejtës ujore. Neni plotësohet se kufizimi i të drejtës ujore mund të ndodhë edhe nëse: rrezikohet arritja e qëllimeve mjedisore të përcaktuara për periudhën e planifikimit në Planin për menaxhim me pellgjet lumore.

Në nenin 51 bëhet ndryshim i revokimit të lejes dhe shtohen raste në të cilat leja mund të revokohet, si më poshtë: nëse nuk paraqiten të dhëna dhe përlllogaritje për sasi të përdorura të ujit dhe nëse bartësi i lejes nuk vepron brenda afatit të caktuar.

Në nenin 52 bëhet sqarimi plotësues i kompensimit të dëmit, i cili përjashton mundësinë e të drejtës për kompensim për fitimin e humbur.

Në nenin 54 në procedurën për dhënien e koncesionit për përdorimit të ujit parashihet detyrim, krahas përgatitjes së propozimit të arsyetuar, të përgatitet edhe studim fizibiliteti për dhënien e koncesionit për përdorimin e ujit të përgatitur në përputhje me rregulloren për dhënien e koncesionit dhe partneritetin publik privat. Propozimi i arsyetuar i dorëzohet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut pas debatit publik të zhvilluar paraprakisht për studimin e fizibilitetit dhe është dhënë mendim pozitiv nga organi i administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e veprimtarive në fushën e bujqësisë, organi i administratës shtetërore përgjegjëse për kryerjen e veprimtarive në fushën e ekonomisë, organi i administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e veprimtarive në fushën e transportit dhe lidhjeve, organi i administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e veprimtarive në fushën e mbrojtjes, organi i administratës shtetërore përgjegjëse për kryerjen e veprimtarive në fushën e kulturës, organi i administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e veprimtarive në fushën e punëve të brendshme dhe Drejtoria për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore.

Pas nenit 54, shtohet nen i ri 54-a, i cili i referohet pjesëmarrjes së publikut në procedurën e dhënies së koncesioneve. Ligji vendos detyrimin për publikimin e studimit të fizibilitetit në faqen e MMJPH-së dhe në ueb faqen e komunës në zonën e së cilës jepet koncesioni. MMJPH ka obligim të ftojë sektorin joqeveritar të marrë pjesë në debatin publik si dhe të mbajë debat publik në zonën ku jepet koncesioni. MMJPH-ja është e obliguar të publikojë procesverbalin e seancës publike në ueb faqen e saj si dhe të përgatisë një raport nga konsultimet e mbajtura publike.

Në nenin 57 bëhet ndryshimi i periudhës kohore për të cilën jepen koncesionet për prodhimin e energjisë elektrike në hidrocentrale me.

Në nenin 58 në paragrafin (2) në alineja 2 ndryshon kompensimi për koncesion dhe për ambalazhimin e ujit thuhet se paguhet çdo vit në përputhje me marrëveshjen e koncesionit.

Në nenet 61, 63 dhe 65 ndryshohet titulli i Bazës së ekonomisë ujore, përkatësisht quhet Baza e Ekonomisë Ujore për Menaxhim të Integruar të Ujërave.

Në nenin 66 bëhet korrigjim në referencën e neneve në ligj.

Në nenin 70 shtohet një paragraf të ri i cili përshkruan detyrimin për harmonizimin e planit kombëtar për menaxhim të pellgut lumor me planin ndërkufitar të pellgut lumor, nëse ekziston një i tillë.

Në neni 74 të Ligjit përcaktohet se organet e administratës shtetërore, si dhe organet e komunës, qytetit të Shkupit dhe komunave në qytetin e Shkupit, të cilat, në pajtim me këtë apo me ligjin tjetër, janë kompetente për kryerjen e veprimtarive të caktuara sipas programit të masave, obligohen në mënyrë të pavarur ose në marrëveshje dhe/ose bashkëpunim me një autoritet tjetër kompetent, të marrin të gjitha masat e nevojshme për arritjen e objektivave mjedisore të përcaktuara në Plan.

Në nenin 75 shtohet një detyrim të ri i cili parashikon detyrim për MMJPH të informojë Qeverinë e RMV-së, një herë në gjashtë vjet për zbatimin e bazës ekonomisë ujore, planet e menaxhimit të pellgjeve lumore dhe Programin e masave, si dhe për Bazën e ekonomisë ujore.

Në neni 79 të propozim - ligjit bëhet rregullimi plotësues i procedurës së dhënies së lejeve për shkarkim që janë pjesë e lejeve të integruara ekologjike.

Në nenin 80 bëhet saktësimi plotësues i alinesë 7 nga paragrafi (7) i nenit 80 të propozim - ligjit ku përcaktohet se dokumenti nga seria e fundit e analizave laboratorike të ujërave të zeza që derdhen në sistem nuk duhet të jetë më i vjetër se gjashtë muaj.

Në nenin 82 bëhen përmirësime teknike të nenit.

Në nenin 84, bëhen ndryshime dhe plotësime të nenit me të cilat rregullohet mënyra e ndryshimit dhe plotësimit të lejes për shkarkim. Me ndryshimet bëhet saktësimi plotësues i kushteve për të cilat mund të kërkohet ndryshimi dhe plotësimi i lejes për shkarkim. Gjithashtu bëhet sqarimi plotësues i dokumenteve që duhet të dorëzohen për ndryshimin dhe plotësimin e licencës.

Në nenin 85 ndryshon vlefshmërinë kohore e lejes dhe në vend të dhjetë viteve aktuale afati për të cilin është lëshuar është gjashtë vjet, si dhe afati për paraqitjen e kërkesës për kohëzgjatjen e lejes ndryshohet nga gjashtë muaj në tre muaj.

Në nenin 87 bëhet korigjim teknik i ligjit.

Në nenin 89 bëhet sqarimi plotësues i kompensimit të dëmit, me çka përjashtohet mundësia e të drejtës për kompensim për fitimin e humbur.

Në nenin 90, i cili rregullon qëllimet e mjedisit jetësor për ujërat sipërfaqësore, si qëllim ndër të tjerat parashihet edhe sigurimi i rrjedhës ekologjike në trupat ujorë.

Me qëllim zbatimin dhe saktësimin e dispozitave të nenit 95 të propozim - ligjit për shmangie nga qëllimet mjedisore, i njëjti ndryshohet me theksim plotësues të arsyeve pse mund të ketë shmangie nga arritja e qëllimeve mjedisore.

Në nenin 98 ndryshohet baza juridike në paragrafin (6), me të cilën thjeshtësohet baza ligjore për miratimin e Regjistrit të zonave të mbrojtura.

Në nenin 99 bëhet korigjim teknik në nen.

Në nenin 105 shtohet një paragraf i ri i cili rregullon mënyrën e përdorimit të plehrave artificiale, produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe produkteve biocide që kryhen në përputhje me zonimin e liqeneve natyrorë dhe rezervuarëve.

Në nenin 108, i cili rregullon funksionimin e impianteve dhe instalimeve që punojnë me substanca të rrezikshme, plotësohet paragrafi (3), përkatësisht saktësohet duke iu referuar dispozitave të ligjit për mjedis jetësor që kanë të bëjnë me parandalimin dhe kontrollin e avarive.

Në nenin 111 të propozim - ligjit, bëhet ndryshim i referencës në vend të paragrafit (8), referohet neni 92 i cili përcakton qëllimet mjedisore dhe mënyrën e menaxhimit të ujërave nëntokësore. Po ashtu është bërë një ndryshim në paragrafin (3) të të njëjtit nen, i cili parashikon se në cilat raste mund të lejohet shkarkimi i materieve dhe substancave, përkatësisht vetëm për ri-injektim në të njëjtin akuifer të ujit të përdorur për qëllime gjeotermale, ujërave që pompohen nga miniera dhe gurore ose ujëra që pompohen gjatë punimeve të ndërtimit dhe në raste të tjera specifike.

Në nenin 114 saktësohet në mënyrë plotësuese pika 1 e paragrafit (1).

Në nenin 120 bëhet saktësimi dhe zëvendësimi i prurjes minimale me prurjen ekologjike. Rrjedha ekologjike përcaktohet gjithashtu edhe në përkufizimet e shtuara në propozim ligjin. Në këtë nen ndryshohet edhe organi kompetent për përcaktimin e pikave matëse, përkatësisht në vend të MMJPH-së, si më parë, kalon në kompetencë të Drejtorisë për Punë Hidrometeorologjike.

Në nenet 123 dhe 126 të propozim ligjit bëhet harmonizimi i neneve në ligj.

Në nenin 130 ndryshon mënyra e përgatitjes së raportit për gjendjen e nivelit dhe sasisë së ujit të akumuluar në rezervuarë, si dhe sasinë e ujit që hyn dhe derdhet prej tyre në vend të metodologjisë që duhet të përpilohet nga ministri i Mjedisit Jetësor dhe ministri i Bujqësisë do të kryhen në përputhje me rregulloret për mbrojtje dhe shpëtim.

Në paragrafin (5) është bërë ndryshim në lidhje me kompetencën për informim për sasi të ujore kritike përkatësisht ky obligim i është dhënë drejtpërdrejtë Drejtorisë për Punë Hidrometeorologjike.

Në nenin 132 në paragrafin (1) bëhen ndryshime terminologjike ndërsa pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3) i cili specifikon pëlqimin e dhënë nga MMJPH për zonën bregore të rrjedhës ujore jashtë vendbanimit si dhe parashikon dokumentet që duhet të dorëzohet me qëllim të dhënies së pëlqimit.

Në Ligj bëhet ndryshim dhe plotësim i titullit të kreut V si dhe neni 142 me të cilin rregullohet mbrojtja dhe përmirësimi i regjimit të trupave ujqorë sipërfaqësorë. Leja aktuale për nxjerrjen e rërës, zhavorrit dhe gurit zëvendësohet me leje të re për rregullimin e brigjeve dhe shtretërve të trupave ujqorë sipërfaqësorë të lëshuar nga organ profesional. Ndërsa për rregullimin e brigjeve dhe shtretërve të trupave ujqorë sipërfaqësorë bëhet në bazë të pëlqimit të lëshuar për ekonomi ujore në përputhje me Ligjin për ujërat. Në Ligj gjithashtu theksohet se rregullimi i shtretërve të lumenjve dhe brigjeve të trupave ujqorë sipërfaqësorë mund të bëhet nga persona juridikë që kanë leje ndërtimi në përputhje me Ligjin për ndërtim.

Neni 142 -a, i cili ndryshohet, parashikon dokumentacionin për dhënien e lejes për rregullimin e shtretërve të lumenjve dhe brigjeve të trupave ujqorë sipërfaqësorë, i cili paraqitet si shtojcë e kërkesës për dhënien e lejes.

Neni 142-b është nen i ri i cili parasheh procedurën për lëshimin e lejes për rregullimin e shtretërve të lumenjve dhe brigjeve të trupave ujqorë sipërfaqësorë, gjegjësisht se organi profesional është i detyruar t'ua paraqesë kërkesën organeve të tjera përkatëse.

Neni 142 - c rregullon detyrimet për mbajtësin e licencës, përkatësisht Ekonomitë ujore dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale janë të detyruara t'ua përmbahen kushteve në leje, si dhe të mbajnë ditar në të cilin do të evidentohen sasia e rërës së nxjerrë, zhavorrit, në baza ditore dhe të dhëna të tjera të nevojshme. Gjithashtu, mbajtësi i lejes është i detyruar

të paraqesë raport gjeodezik për aktivitetet e kryera brenda tre muajve nga përfundimi i aktivitetit.

Në nenin 142 - d, bëhen ndryshime edhe në lidhje me trajtimin e materialit të nxjerrë gjatë rregullimit të shtretërve dhe brigjeve të trupave ujorë sipërfaqësorë dhe përcaktohet qartë se për çfarë mund të përdoret: të vendoset / shpërndahet në të njëjtin trup ujor pa e nxjerrë në brigje, të përdoret për objekte mbrojtëse për menaxhimin e ujit ose për mbrojtje të rregullt ose emergjente nga vërshimet, me ose pa nxjerrjen paraprake në brigjet dhe të përdoret për ndërtimin e objekteve dhe kryerjen e punëve me rëndësi për Republikën e Maqedonisë së Veriut. Materiali i nxjerrë që nuk do të përdoret, bartësi i lejes mund ta shesë në treg të hapur, me ankand publik, me ç'rast çmimi i shitjes së materialit nuk mund të jetë më i ulët se çmimi i shitjes së materialit në treg i përcaktuar në përputhje me rregulloret në fushën e lëndëve të para minerale.

Në nenin 144 bëhet sqarim teknik i nenit.

Në nenin 145, obligimi për përcaktimin e kushteve, mënyrën dhe procedurën për themelimin dhe funksionimin e të gjitha rrjeteve për monitorimin e gjendjes së trupave ujorë mbetet të miratohet nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, por me propozimin e Drejtorisë Hidrometeorologjike.

Në nenin 146 gjithashtu kompetenca për monitorimin e përgjithshëm të monitorimit të trupave ujorë të përfshirë nga rrjeti shtetëror për monitorimin, zbatimin, funksionimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin ia delegon Drejtorisë Hidrometeorologjike.

Në nenin 148 ndryshohet paragrafi (11) me të cilin Ministria e Shëndetësisë është kompetente të përgatisë raporte vjetore për gjendjen e ujit të destinuar për konsum nga njerëzit dhe t'i publikojë në ueb faqen e saj.

Në nenin 150, detyrimi i MMJPH-së për publikim të raporteve për gjendjen e shkarkimit të ujërave të zeza reduktohet në një vit në vend të dy.

Në nenin 155 bëhet korigjim teknik në nen.

Me ndryshimin e nenit 161 konkretisht paragrafi (5) parasheh detyrimin që kadastra e ndotësve të jetë në dispozicion të publikut në ueb faqen e MMJPH-së.

Në nenet 162, 163 dhe 164 bëhet saktësimi plotësues i dispozitave të ligjit dhe harmonizimi i tyre me ndryshimet e mëparshme të propozim - ligjit.

Në nenin 165 shtohet paragrafi të ri (3) i cili parashikon detyrimin për personin juridik ose fizik që kap ujë nga trupat ujorë sipërfaqësorë të ndërtojë dhe mirëmbajë impiante përkatëse (shtigjet e peshkimit) në gjendje të mirë, në përputhje me praktikën ose teknikat më të mira të disponueshme për lëvizjen e pa penguar të peshqve.

Në nenin 166 bëhet korigjim teknik i nenit për shkak të harmonizimit me nenet e tjera të propozim - ligjit.

Në nenin 167 bëhet sqarim plotësues në paragrafin (1) të propozim - ligjit.

Në nenin 174 në paragrafin (5) përcaktohet se për të gjitha objektet për të cilat kërkohet lëshimi i lejes për shfrytëzim ose leje shkarkimi, lejet e lëshuara zëvendësojnë pëlqimin për ekonomi ujore.

Neni 179 ndryshohet për të përcaktuar në mënyrë plotësuese periudhën e vlefshmërisë së pëlqimit për ekonomizim ujor. Pëlqimi i ekonomisë ujore do të pushojë të vlejë nëse investitori nuk jep leje ndërtimi në përputhje me Ligjin për ndërtim brenda një viti nga dhënia e lejes për ekonomi ujore dhe do të pushojë të vlejë deri në përfundimin e lejes për

ndërtim. Nëse për objektet nuk kërkohet sigurimi i lejes për ndërtim, pëlqimi për ekonomi ujore pushon të vlejë brenda dy viteve nga dita e lëshimit të tij.

Ndryshimet në nenin 183 paragrafi (4) synojnë qartësimin e mëtejshëm të nenit.

Ndryshimi dhe plotësimi i nenit 191 është për shkak të harmonizimit me Ligjin për ekonomi ujore.

Me ndryshimin dhe plotësimin e nenit 198 jepet bazë ligjore për përcaktimin e një akti nënligjor për formën dhe përmbajtjen e studimit për analizën dhe vlerësimin e qëndrueshmërisë dhe funksionalitetit të digave dhe akumulimeve.

Dispozitat e nenit 192 shlyhen me qëllim të harmonizimit të legjislacionit ekzistues kombëtar.

Me ndryshimin në nenin 200 bëhet harmonizimi me nenin 195 të propozim - ligjit.

Në nenin 202 shlyhet paragrafi (2), me të cilin shlyhet detyrimi për miratimin e aktit nënligjor ndërsa mbetet detyrimi për raportim.

Me nenin 208 bëhet ndryshimi i mënyrës së pagesës së kompensimit dhe i referohet nenit 142-d të propozim - ligjit.

Në nenin 213 të propozim - ligjit janë bërë ndryshime në pjesën e arkëtimit të kompensimit për:

- prodhimin e energjisë elektrike dhe i njëjti ende është 1%, por në vend të të gjithë prodhimit, tarifohet nga shitja për kilovat orë në pragun e termocentralit në hidrocentrale. Kjo mënyrë e llogaritjes së kompensimit do të mundësojë procedurë më të thjeshtë dhe uniforme për llogaritjen e kompensimit sepse çmimi i shitjes së energjisë elektrike përcaktohet për dallim nga çmimi i prodhimit të cilin e përcakton secili individualisht.
- ambalazhimin të ujit për qëllime komerciale në vend të "0,5% të çmimit të përcaktuar të shitjes së produktit" parashikohet të jetë 2% e çmimit të përcaktuar në sistemin e ujësjellësit publik. Në paragrafin (18) ndryshon edhe mënyra e arkëtimit të kompensimit dhe arkëtohet nga dita e përdorimit të ujit për ambalazhim dhe paguhet në llogarinë e veçantë pagesore në llogarinë e thesarit në bazë mujore. Kjo mënyrë e arkëtimit të kompensimit lidhet me përdorimin e ujit dhe jo me shitjen e ujit pavarësisht se sa shitet.
- Uji i përdorur për kultivimin e peshkut, në pellgje peshqish dhe në kafaze dhe shpend uji, në vend të 3% ndryshon në 1% për kilogram të çmimit të shitjes së peshkut ose shpendit në momentin e lëshimit në treg.

Me shtimin e paragrafit të ri (31) përcaktohet detyrimi për obliguesit një herë në muaj, gjatë muajit mars të vitit aktual të paraqesin në MMJPH raport për ujin e përdorur për vitin paraprak dhe të dhëna për kompensimet e llogaritura dhe të paguara.

Me ndryshimin në nenin 215 paragrafi (2) ndryshohet me qëllim të harmonizimit të ndryshimeve të mëparshme të propozim - ligjit.

Gjithashtu shtohet paragraf i ri, me të cilin imponohet detyrimi obliguesi të paguajë kompensim përkatësisht mbajtësi i lejes për rregullimin dhe pëlqimin për ekonomi ujore për rregullimin e shtretërve të lumenjve dhe brigjeve të trupave ujqorë sipërfaqësorë duhet të dorëzojë në MMJPH gjatë muajit mars të vitit aktual të dhënat për rërën, zhavorrin dhe gurin e nxjerrë dhe llogaritjen e kompensimit për vitin e kaluar.

Me nenin 218 parashihet detyrimi për realizimin e Programit të kryhet vetëm nga MMJPH dhe jo nga organe të tjera.

Me nenin 223 të propozim - ligjit përcaktohet mandati i anëtarëve në këshillin për menaxhim me pellgjet lumore, i cili është 6 vjet.

Në nenin 230 shtohet kompetenca e inspektorit të ekonomisë ujore lidhur me mundësinë e mbikëqyrjes

Në pjesën e mbikëqyrjes inspektuese në nenin 232, inspektorit shtetëror të natyrës i shtohen kompetenca për të kryer mbikëqyrjen në zonat e mbrojtura.

Kompetencat e inspektorit shtetëror të natyrës përcaktohen në nenin 232 - a të propozim - ligjit.

Me nenin 233 bëhet zgjerimi i kompetencave të inspektorit të autorizuar për mjedis jetësor.

Ndryshimet në nenin 234 janë në funksion të harmonizimit me ndryshimet e mëparshme të propozim - ligjit.

Ndryshimet në nenet 235 dhe 237 specifikojnë më tej kompetencat e inspektorit shtetëror për bujqësi dhe inspektorit sanitaro-shëndetësor.

Aktet nënligjore që dalin nga propozim - ligji do të përgatiten brenda një viti nga hyrja në fuqi e ligjit.

## **II. LIDHJA E NDËRSJELLË E ZGJIDHJEVE TË PËRFSHIRA NË DISPOZITAT E PROPOZUARA**

Të gjitha zgjidhjet në ligj janë të ndërlidhura dhe plotësojnë njëra-tjetrën.

## **III. PASOJAT QË DO TË REZULTOJNË NGA ZGJIDHJET E PROPOZUARA**

Zgjidhjet e propozuara në ligj synojnë saktësimin dhe shpjegimin plotësues të propozim - ligjit në fushën e lëshimit të lejeve për të drejtën ujore. Me ndryshimin e mënyrës së mbrojtjes dhe përmirësimin e regjimit të ujit, do të sigurohet një mënyrë më e rregulluar e nxjerrjes së rërës, zhavorrit dhe gurit, e cila do të kontribuojë në reduktimin e përdorimit të materialit nga shtretërit e lumenjve dhe shtretërve të lumenjve të trupave ujqorë sipërfaqësorë. Gjithashtu, detyrimi për përgatitjen e studimit të fizibilitetit gjatë procedurës për dhënien e koncesionit për shfrytëzimin e ujit do të sigurojë transparencë më të madhe mbi procesin e dhënies së koncesioneve për shfrytëzimin e ujit. Të gjitha këto ndryshime dhe plotësime synojnë përdorimin më të mirë dhe më të qëndrueshëm të burimeve ujore.